

Nr.....

Datë 08.02.2021

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Shoqëria Gjoka Konstruksion Sha është krijuar në vitin 1994 me vendim gjykate Nr.3306. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr.7638, datë 19 Nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria Gjoka Konstruksion Sha është një shoqëri Shqiptare, me administrator të saj z. **Rrok GJOKA**.

Aksioneri i vetëm i shoqërisë është z. Rrok GJOKA që zotëron 100 % të kapitalit.

Kapitali i shoqërisë në Shqipëri është 2.700.000.000 Lek dhe është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

Shoqëria Gjoka Konstruksion Sha gjatë vitit 2008 ka hapur një filial te saj ne Kosove, me seli Rruga per Mitrovice, Prishtine.

Kapitali i shoqërisë në Kosovë është 2.500 Euro ose 309.250 Lek i vlerësuar me kursin e datës 31.12.2020, 1 eur=123.7 lek

Në zbatimin të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.634, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension / partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale", të ndryshuar, dhe kontratës koncesionare/ppp "Për përmirësimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit", të lidhur në Tiranë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr.553 rep, nr.247kol, datë 16.03.2018 dhe të miratuar me VKM nr.180, datë 23.03.2018, e të botuar në Fletoren Zyrtare nr.50, datë 11.04.2018, nga shoqëria Gjoka Konstruksion Sha u themelua me datë 16.04.2018 shoqëria Gjoka 87 sh.p.k. me ortak të vetëm 100% shoqërinë Gjoka Konstruksion Sha.

Shoqëria Gjoka Konstruksion Sha ka interesa pjesmarrje në shoqëritë si më poshtë:

Emri i shoqërisë	Vlera në Lekë
Aksione në shoqërinë Gjoka Konstruksion - Energji shpk	600,000
Aksione në shoqërinë Diteko shpk	50,000
Aksione në shoqërinë Gjoka 87 shpk	1,809,272,309

Adresa:

Selia e shoqërisë mëmë Gjoka Konstruksion Sha ndodhet në Rr. Dora D'Istria Hyrja 1 dhe 2, Tiranë. Ajo është regjistruar në Degën e Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT: J91815014U.

Selia e shoqërisë Gjoka 87 sh.p.k. ndodhet në Rr. Dora D'Istria Hyrja 6, Tiranë. Ajo është regjistruar në Degën e Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT: L81618040T

Selia e shoqërisë Gjoka Konstruksion - Përfaqësia Kosovë ndodhet në adresën rruga për Mitrovicë. Ajo është e regjistruar në administratën tatimore të Kosovës me NRF: 600232475 NRB:70508788



Objekti i Aktivitetit: Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ndërtimi në infrastrukturën rrugore dhe atë të ujësjellës kanalizime, etj
Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të zgjasë më shumë se 10 vjet.

BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

a. Mënyra e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe interpretimet e ligjit Nr. 9228, datë 29 Prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK).

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera, dhe parimit të të drejtave të kostatuara.

c. Përdorimi i gjykimeve dhe hamendësimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare konform SNRF-ve, kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi dhe në cdo periudhë të ardhme që preket.

d. Ndryshime në politikat kontabël

Duke nisur nga 1 Janar 2011, Shoqëria ka ndryshuar politikat kontabël në paraqitjen e Pasqyrave Financiare duke aplikuar Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Shoqëria ndjek SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* të rishikuar, efektive në 1 Janar 2011.
Për vitin 2018 nuk ka ndryshime në politikat kontabël.

e. Bazat për konsolidim

Pasqyrat financiare të shoqërisë paraqiten të konsoliduara, duke përfshirë Pasqyrat Individuale të shoqërisë “Gjoka Konstruksion” Sha në Shqipëri dhe “Gjoka Konstruksion” Sha në Kosovë krijuar gjatë vitit 2008. Kështu Bilanci i filialit të Kosovës i cili është i shprehur në EUR është konvertuar në monedhën vendase LEK me kursin e zyrtar të shpallur nga **Banka e Shqipërisë** datë 31.12.2020: 1 Euro = 123,7 ALL.

Të gjitha transaksionet dhe balancat ndërmjet të shoqërive të Grupit janë eliminuar në konsolidim, duke përfshirë fitimet e parealizuar dhe humbjet nga transaksionet ndërmjet shoqërive të Grupit. Shumat e raportuara në pasqyrat financiare të Shoqërive të Kontrolluara janë përshtatur aty ku është e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me politikat kontabël të miratuara nga Grupi. Grupi i atribuon të ardhurat totale gjithëpërfshirëse apo humbjen e filialeve ndërmjet pronarëve të Shoqërisë mëmë dhe interesave jo-kontrolluese në bazë të interesave të tyre përkatëse pronësore.

Përfundim në konsolidim bën shoqëria Gjoka 87 sh.p.k., duke qënë se 100% i aktivitetit të saj ushtrohet në zbatim të kontratës koncesionare/ppp, ku shoqëria mëmë Gjoka Konstruksion Sha është nënkontraktori kryesor. Në këtë rast konsolidimi nuk do të paraqiste një pamje të vërtetë dhe të sigurtë të të ardhurave dhe shpenzimeve gjithëpërfshirëse dhe të pasqyrave financiare në tërësi.



f. Monedha Funktionale dhe me të cilën paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhen vendase Lek (ALL), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e shoqërisë. **Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.**

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer në pasqyrën e bilancit me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë me 31.12.2020. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet dhe detyrimet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj që paraqiten me vlerën e drejtë përkthehen me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është përcaktuar.

Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas **Bankës së Shqipërisë** më 31.12.2020, ka qenë respektivisht si më poshtë:

Monedha

1 EURO = 123.7 lek

1 USD = 100.84 lek

ZBËRTHIME TË ZËRAVE TË BILANCIT**AKTIVI****I. AKTIVE AFATGJATA****Njohja dhe matja**

Aktivet afat-gjata materiale janë aktive të trupëzuara të cilat mbahen për përdorim në ofrimin e shërbimeve ose për qëllime administrative.

Zërat e aktiveve afat-gjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga zhvlerësimi. Kostoja historike përfshin shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e këtyre elementeve. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shumatat e marra me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferencën në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave në zërin 'Fitime/(humbje) të tjera'.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën e mbetur të zërit përkatës nëse është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin në fjalë do të merren nga Grupi dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen në të ardhura ose shpenzime.

Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime mbi vlerën e mbetur të aktivitetit për ndërtesat, kompjuterat, furniturat dhe pajisje dhe mjetet e transportit. Toka nuk amortizohet. Vlera e rikuperueshme dhe jetët e dobishme rishikohen, dhe nëse është e nevojshme bëhen rregullimet përkatëse, në çdo datë bilanci.



Toka, ndërtesa, makineritë e pajisjet maten me vlerën e kostos historike minus amortizimin e akumuluar. Kosto përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo daljet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitet e patrupëzuara përfshijnë licencat dhe të drejtat për përdorim sic janë Certifikatat ISO.

Aktivitet afatgjata paraqiten si mëposhtë:

		Viti 2020	
AKTIVE AFATGJATA	Monedha	VLERA	
1 Aktivet afatgjata materiale			
Toka	LEK	41,320,080	
Makineri dhe pajisje	LEK	919,022,379	
Aktive te tjera afatgjata materiale (me vlere kontabile)	LEK	5,765,067	
Ndertesat	LEK	111,515,695	
TOTALI Aktivet afatgjata materiale		1,077,623,221	
2 Aktive te tjera afatgjata jo-materiale			
Programe financiare + Certifikata ISO	LEK	62,211	
TOTALI Aktive te tjera afatgjata jo-materiale		62,211	
3 Investime ne pjesmarrje			
Aksione ne shoqerine Gjoka Konstruksion - Energji shpk	LEK	600,000	
Aksione ne shoqerine Diteko shpk	LEK	50,000	
Aksione ne shoqerine Gjoka 87 shpk	LEK	1,809,272,309	
TOTALI Investime ne pjesmarrje		1,809,922,309	
TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA		2,887,607,741	

Bashkëngjitur shënimeve shpjeguese janë dhe pasqyrat analitike të shtesave, pakësimeve dhe amortizimit të Aktiveve Afatgjata

II. AKTIVE AFATSHKURTRA

1. Vlerësimi i Gjendjeve të Inventarit

Inventaret regjistrohen në kontabilitet me vlerën e drejtë. Vlera përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Inventari datë: 31.12.2020

Inventare dhe aktive biologjike afatshkurter

NR.	LLOJI I MATERIALIT	NJESI	SASI	CMIM	VLERE
1	Nafte	liter	11,490	109.77	1,261,311
2	Hekur	Kv	26	5,298.13	137,751
Inventare dhe aktive biologjike afatshkurter					1,399,063

2. Aktive afatshkurtra - Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme
Kërkesat për arkëtim vlerësohen me vlerën nominale (të skontuara nëse është materiale) minus humbjen nga zhvlerësimi. Kërkesat për arkëtim sipas kategorive për shoqërinë mëmë dhe filialin në Kosovë paraqiten si mëposhtë:

Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
		VLERA	VLERA
Kliente te ndryshem autoritete			
1 publike	LEK	456,329,298	26,587,455
2 Kliente te ndryshem	LEK	11,615,916,416	8,521,280,420
3 Garanci punimesh	LEK	84,030,565	41,027,482
Parapagime per materiale te			
4 ndryshme	LEK	14,516,295	6,713,520
Tvsh e paguar ne dogane, tatim			
5 ne burim, tatim fitimi	LEK	2,247,753	67,501,737
Të drejta në shoq pjesmarrëse			
6 dhe ortake	LEK	295,822,367	292,204,374
7 Kërkesa të tjera të arkëtueshme	LEK	482,547,624	534,887,429
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme		12,951,410,318	9,490,202,417

Llogari të Arkëtueshme nga klientët në Kosovë 66,362,548.00 Lek

Total I Konsoliduar - Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme	13,016,448,481 lek
--	---------------------------

Për efekt të konsolidimit të pasqyrave financiare të zëri i tatimit mbi fitimin të mbipaguar në Shqipëri zbresim tatimin shtesë 5% mbi fitimin për Kosovën që është 1,324,385 lek (696,993 lek per vitin 2020; 234,404 lek per vitin 2019 dhe 392,986 lek per vitin 2018)

3. VLERËSIMI I LIKUIDITETEVE

Instrumentat financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumenta financiare jo-derivative që përfshijnë llogari të arkëtueshme nga klientët, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe të dhëna, depozita bankare, letra me vlerë afatshkurtra dhe llogari të tjera për t'u paguar apo për t'u arkëtuar me karakter tregëtar. Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhet me to, përveç rasteve të vecanta.



Llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat, njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e krijimit të tyre. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj përfshijnë tepricat e arkës, bankës, depozitat në banka investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi më pak se 1 vit, të cilat nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to paraqiten si mëposhtë:

Nr	Mjete monetare dhe ekuivalente me to	Monedha	Balanca në fund mon. llog	Kursi	Vlera në Lek
1	Banka	LEK	359,196	1	359,196
2	Banka	EUR	106,091	123.7	13,123,480
3	Banka	USD	371	100.84	37,380
4	Arka	LEK	34,311	1	34,311
Totali					13,554,368

Mjete monetare Arkë dhe Bankë Filiali në Kosovë

6,085,894 Lek

TOTALI I KONSOLIDUAR - Mjete monetare dhe ekuivalente me to	19,640,262 lek
--	-----------------------

KAPITALI

I. KAPITALET E VETA PËR SHOQËRINË MËMË NË SHQIPËRI

Fitimi i Vitit Ushtrimor 2018 në shumën 1,866,306,371 lek, u destinua si më poshtë:

1. Kalim në rezerva ligjore të shoqërisë mëmë në shumën 93,315,319 lek.
2. Kalim në rezerva të tjera të shoqërisë mëmë në shumën 1,772,991,052 lek.

Si konkluzion në pasqyrat individuale Shqipëri:


- Zëri: Kapitali aksionar mbetet 2,700,000,000 lek
- Zëri: Rezerva statutore dhe ligjore ishte 180,697,594 lek dhe u bë 274,012,913 lek
- Zëri: Rezerva të tjera ishte zero lek dhe u bë 1,766,310,252 lek

Fitimi i Vitit Ushtrimor 2019 per pasqyrat e konsolidura në shumën 1,196,555,865 lek, u destinua si më poshtë:

1. Kalim në rezerva ligjore të shoqërisë mëmë në shumën 59,827,739 lek.
2. Kalim në rezerva të tjera të shoqërisë mëmë në shumën 1,136,728,072 lek.

Fitimi i Vitit Ushtrimor 2019 per pasqyrat individuale në shumën 1,192,740,022 lek, u destinua si më poshtë:

1. Kalim në rezerva ligjore të shoqërisë mëmë në shumën 59,827,739 lek.
2. Kalim në rezerva të tjera të shoqërisë mëmë në shumën 1,132,912,229 lek.



Si konkluzion në pasqyrat individuale Shqipëri:

- Zëri: Kapitali aksionar mbetet 2,700,000,000 lek

Zëri: Rezerva statutore dhe ligjore ishte 274,012,913 lek dhe u bë 333,840,706 lek

Zëri: Rezerva të tjera ishte 1,766,310,252 lek dhe u bë 2,899,222,481 lek

II. DETYRIME AFATGJATË

1. Huamarrje afatgjate

Nr.	Detyrime afatgjata	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Huamarrje ne banke	LEK	74,241,977	-
Huamarrje			74,241,977	-

Nr.	Te ardhura te shtyra	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Të ardhura në avancë Gjiguria	LEK	8,435,750	8,435,750
Te ardhura te shtyra			8,435,750	8,435,750

III. DETYRIME AFATSHKURTËR

1. Vlerësimin e detyrimeve të pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme

Llogaritë e furnitorëve dhe të tjera llogari të pagueshme janë vlerësuar me vlerën e drejtë.

Nr.	Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Furnitore te ndryshem Të drejta dhe detyrime ndaj	LEK	6,939,614,415	5,339,702,108
2	Kosovës	LEK	512,020,242	367,970,142
3	Dividentë për t'u paguar	LEK	20,000,000	20,000,000
4	Kreditorë të ndryshëm	LEK	102,826,040	147,739,607
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme			7,574,460,697	5,875,411,857

Llogari të Pagueshme ndaj Furnitorëve Kosova janë **542,427,098** lek

Zbritur Huaja e shoqërisë mëmë ndaj filialit në vlerën 4,077,175 euro (512,020,242 lek)

Totali llogari të pagueshme ndaj Furnitorëve Kosove 28,686,189 lek

TOTALI I KONSOLIDUAR Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	7,603,146,886 Lek
---	--------------------------

2. Huamarrje afatshkurter

Nr.	Huamarrje afatshkurter	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Hua bankare overdraft	LEK	81,044,976	98,464,055
Huamarrje			81,044,976	98,464,055

3. Detyrime per tatimin aktual

Nr.	Detyrime per tatimin aktual	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Paga dhe shpërblime Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	LEK	54,437,114	44,911,296
2	Tatim mbi të ardhurat personale	LEK	8,938,272	7,140,591
3	Tatim mbi fitimin Shteti- TVSH për t'u paguar	LEK	2,225,559	1,866,182
4		LEK	158,928,285	-
5		LEK	68,159,232	121,759,060
Detyrime per tatimin aktual			292,688,462	175,677,129

Detyrimi ndaj tatimeve, sigurimeve dhe punonjësve në Kosovë është 1,720,667 lek

TOTALI I KONSOLIDUAR të drejta dhe detyrime ndaj tatimeve	294,409,129 Lek
--	------------------------

4. Provizione afatshkurtra

Shuma e provizioneve është 3,316,088 lek

5. Detyrime afatshkurtra / Te ardhura te shtyra



Nr.	Detyrime afatshkurtra / Te ardhura te shtyra	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Paradhenie sipas kontrates no. WRIP/1/W001-A. Rehabilitation of Janiari System Konispol	LEK	31,937,386	
Detyrime afatshkurtra / Te ardhura te shtyra			31,937,386	-

6. Parapagime të arkëtuara

Shuma të arkëtuara nga individë të ndryshëm për prenotim apartamentesh në godinat e banimit në Komunën Dajt. Kjo shumë është **189,254,303 lek**.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE

(a) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mallrave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të kompanisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet. GJOKA KONSTRUKSION sh.a njeh të ardhurat duke u bazuar në faturat e lëshuara. Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës. Të ardhurat nga interesat regjistrohen në momentin e maturimit të tyre.

(b) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë bankare dhe përfitimet nga diferencat e këmbimit. Interesat njihen ashtu siç përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga diferencat e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

(c) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e shtyrë dhe atë aktual. Tatimi mbi fitimin paraqitet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përjashtuar rastet kur lidhet me zërat e kapitalit e për rrjedhim paraqitet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i parashikuar për t'u paguar, i përlllogaritur mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit si dhe cdo korigjim të tatimit të pagueshëm të periudhave të mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet si pasojë e diferencave të përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

(d) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një pjesë e politikave kontabël dhe shënimeve shpjeguese të Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare ose jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të matjes apo shënimeve sipas metodave të mëposhtme.



Gjatë vitit 2020 Shoqëria Gjoka Konstruksion - Përfaqësia në Kosovë ka zhvilluar aktivitetet në zbatim të kontratës së lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës në Republikën e Kosovës, me objekt: "Ndërtimi i autoudhës A7.1 Kryqëzimi me disnivel A6/A7.1 (Banullë) – Dheu i Bardhe – Pjesa: kryqëzimi në disnivel A6/A7.1 (Banullë) – Udhëkryqi Bresalc –L=22.31 km, Loti 2".

Si rrjedhojë ka realizuar të ardhura dhe shpenzime, të cilat paraqitur në pasqyrat e konsoliduara të shoqërisë mëmë.

Pasqyra e Performances (sipas natyres).

Periudha 01.01.2020 - 31.12.2020

1. Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit

Punime, shërbime dhe shitje e produkteve të gatshëm

Nr.	Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Shitje produkt I gatshëm Shitje sipas situacionit të punimeve	LEK	4,459,500	3,152,868
2		LEK	6,780,924,767	5,706,136,923
3	Shitje restoranti+lokali+palestra	LEK	25,376,879	69,813,045
Të ardhurat nga aktiviteti kryesor			6,810,761,146	5,779,102,836

Të ardhurat nga shitja në filialin e Kosovës janë: 71,856,823 lek

TOTALI I KONSOLIDUAR Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit	6,882,617,969 Lek
---	--------------------------

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Nr.	Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Shitje materiale të para Transport per te tretet, qera	LEK	51,754,465	22,926,490
2	makineri etj	LEK	5,107,982	-
3	Zbritje nga blerjet	LEK	28,942,394	6,235,031
4	Të ardhura të tjera	LEK	39,209,498	452,394
5	Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjatë	LEK	18,990,530	20,004,073
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit			144,004,869	49,617,989



TOTALI I KONSOLIDUAR Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	144,004,869 Lek
---	------------------------

Të ardhurat sipas FDP-ve dhe atyre sipas Pasqyrave Financiare individuale ndryshojnë për vlerën **3,289,994** lek.

Në tabelën e mëposhtme është sqaruar diferenca midis deklaratave sipas FDP-ve dhe të ardhurave sipas Pasqyrave Financiare individuale dhe të konsoliduara për vitin 2020.

		Viti 2020		
		Shqiperi	Kosove	E konsoliduar
	Shifra e afarizmit sipas PASH (shitjet neto)	6,810,761,146	71,856,823	6,882,617,969
	Të ardhura nga veprimtarite e tjera të shfrytëzimit	144,004,869		144,004,869
	Te ardhura subvencion nga Masat, Ndhime pershka te situates se Pandemise		358,807	358,807
	Qarkullimi total	6,954,766,015	72,215,630	7,026,981,645
	Fitim nga kembimet valutore	6,179,948		6,179,948
I	Total te ardhura sipas deklarates se tatim fitimit 2020	6,960,945,963	72,215,630	7,033,161,593
	Shitje të tatueshme sipas FDP total	6,841,179,670	72,215,630	6,913,395,300
	Shitje te perjashtuara	116,476,299		116,476,299
	Eksporte			-
II	Qarkullimi total sipas FDP-ve	6,957,655,969	72,215,630	7,029,871,599
	Diferenca I-II	3,289,994	-	3,289,994
	Kjo diferencë vjen nga :			-
1	Zbritje nga blerjet gjate periudhes	28,942,394		28,942,394
2	Të ardhura të tjera jokorente , rimbursime të shpenzimeve nga shoq e sigurimit për mjete të dëmtuara	105,038		105,038
3	Fat shitje paradhenie per shitje MBZHR	(31,937,386)		(31,937,386)
4	Fitim nga kembimet valutore	6,179,948		6,179,948
	Totali	3,289,994	-	3,289,994

2. Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme

Nr.	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Blerje materiale të para, materiale te tjera, ndihmes, djegëse	LEK	(2,984,859,661)	(2,897,791,415)
2	Blerje, energji, avull, ujë	LEK	(30,418,727)	(22,672,754)

[Signature]

[Stamp: SHQIPERISIA, SH.A., TIRANE - ALBANIA]

3	Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh	LEK	(16,432,333)	(24,646,075)
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme			(3,031,710,721)	(2,945,110,244)

Shpenzimet operacionale në filialin e Kosovës janë: 50,569,221 lek

TOTALI I KONSOLIDUAR Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	3,082,279,942 Lek
--	--------------------------

3. Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi

Amortizimi I aktiveve llogaritet mbi vlerën e mbetur me normën vjetore të amortizimit bazuar në ligjin 8438 date 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe udhëzimet përkatëse nga Ministria e Financave. Amortizimi nuk aplikohet mbi tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim. Amortizimi i Aktiveve afatgjata për vitin 2020 është : **236,555,566 Lek.**

4. Shpenzime personeli

Nr.	Shpenzime personeli	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Pagat dhe shpërblimet e personelit Sigurimet shoqërore dhe	LEK	(358,830,237)	(298,310,201)
2	shëndetsore	LEK	(58,591,294)	(48,219,035)
Shpenzime personeli			(417,421,531)	(346,529,236)

Shpenzimet paga dhe sigurime në filialin e Kosovës janë: 7,325,713 lek

TOTALI I KONSOLIDUAR Shpenzime personeli	424,747,244 Lek
---	------------------------

5. Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto

Nr	Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Shpenzime per Interesa	LEK	(3,400,251)	(2,178,555)
2	Te ardhura nga Interesat	LEK	-	-
3	Humbje nga këmbimet dhe përkthimet valutore	LEK	(5,488,256)	(8,791,103)
4	Fitim nga këmbimet valutore	LEK	6,179,948	7,693,875
Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto			(2,708,559)	(3,275,783)

Handwritten signature



Te ardhura te tjera në filialin e Kosovës janë: 358,807 lek .

Keta te ardhura jane ndihme ekonomike nga qeveria e Kosoves gjate periudhes se pandemise.

TOTALI I KONSOLIDUAR Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto	-2,349,752 Lek
---	-----------------------

6. Shpenzime te tjera

Nr.	Shpenzime te tjera	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
			VLERA	VLERA
1	Punime me nenkontraktore	LEK	(902,361,313)	(530,209,283)
2	Qira	LEK	(18,323,756)	(8,599,090)
3	Mirëmbajtje dhe riparime	LEK	(38,729,746)	(13,088,715)
4	Sig. mjete transporti, kontrate, etj	LEK	(5,661,640)	(65,948,115)
5	Të tjera	LEK	(263,472,393)	(250,353,882)
6	Shpenzime Telefoni	LEK	(1,276,770)	(1,561,077)
7	Shpenzime transporti per blerje	LEK	(45,318,824)	(6,304,939)
8	Shpenzime per Sherbime Bankare	LEK	(3,924,146)	(1,902,138)
9	Taksa, tarifa doganore,tatime të tjera	LEK	(8,626,193)	(27,722,910)
10	Gjoha dhe dëmshpërblime	LEK	(695,182)	(4,146,021)
11	Vlera kontabel e aktive afatgjata te shitura	LEK	(18,411,509)	(21,168,156)
Shpenzime te tjera			(1,306,801,472)	(931,004,326)

Shpenzime të tjera në filialin e Kosovës janë: 22,031 lek

TOTALI I KONSOLIDUAR Shpenzime të tjera	1,306,823,503 Lek
--	--------------------------

Tatimi mbi fitimin

Tatimi aktual mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e ligjit "Për tatimin mbi të Ardhurat në Republikën e Shqipërisë" duke përfshirë gjithë detyrimet për tatimin mbi fitimin të pagueshme për vitin ushtrimor. Tatimet aktuale janë tatime për t'u paguar që rezultojnë nga të ardhurat e tatueshme, duke përdorur shkallën tatimore që është në fuqi në datën e bilancit, dhe çdo rregullim në tatimet për tu paguar që rrjedh nga vitet e kaluara.

Shkalla tatimore për tatimin mbi fitimin sipas ligjit Nr. 8483 dt 28.12.1998 " Për tatimin mbi të ardhurat të ndryshuar" për vitin ushtrimor 2020 është 15 % .

Shkalla tatimore për tatim fitimin në Kosovë për vitin ushtrimor 2020 është 10%

Llogaritja e tatim fitimit dhe plotësimi i formularit të pagesës së tatimit mbi fitimin

Sic edhe është shprehur më sipër Pasqyrat financiare të shoqërisë Gjoka Konstruksion janë të konsoliduara por këtë vit në Kosovë ka pasur veprimtari dhe kjo tabelë i përket veprimtarisë në Shqipëri dhe ne Kosovë.

Llogaritja e rezultatit per vitin 2020

	Të ushtrimit 2020	Tatimore 2020
Të ardhura	7,032,802,786	6,960,945,963
Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri	6,960,945,963	6,960,945,963
Nga Filiali Kosovë	71,856,823	-

Shpenzimet	5,059,294,763	5,001,377,798
Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri	5,001,377,798	5,001,377,798
Nga Filiali Kosovë	57,916,965	-

Shpenzimet e pazbritshme	695,182	695,182
Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri	695,182	695,182
Nga Filiali Kosovë	-	-

Rezultati

Fitimi Para Tatimit	1,974,203,205	1,960,263,347
Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri	1,960,263,347	1,960,263,347
Nga Filiali Kosovë	13,939,858	-

Llogaritja e Tatimit mbi fitimin

Tatim Fitimi me shkallën standarte 15%		
Nga Gjoka Konstruksion Shqipëri 15%	294,039,502	294,039,502
Nga Gjoka Konstruksion Kosovë 10%	1,393,986	
Diferenca 5 % Filiali Kosovë që paguhet në Shqipëri		696,993

Total Tatim Fitimi për t'u paguar në Shqipëri		294,736,495
--	--	--------------------

Tatim i parapaguar

Parapagime Shqipëri viti 2020	135,142,662	
-------------------------------	-------------	--

Total Parapagime viti 2020	135,142,662	-
Tatim fitimi i mbipaguar Shqipëri		-
Tatim fitimi i detyrueshëm për t'u paguar		159,593,833

SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRËN E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË



[Handwritten signature]

Në pasqyrën e ndryshimit të kapitalit janë tre shifra që vijnë si pasojë e efekteve të kurseve të këmbimit në fund të vitit 2020 (1 euro = 123.7 ALL), me atë të vitit 2019 (1 euro = 121.77 ALL), në kapitalin e konsoliduar të shoqërisë.

1. Kapitali i shoqërisë "Gjoka Konstruksion" Sh.a përbëhet nga kapitali i shoqërisë mëmë në Shqipëri me vlerën 2.700,000,000 (dy miliard e shtatëqind milion lek) dhe kapitali i filialit në Kosovë me shumën **2,500 euro** (dymijë e pesëqind euro) shumë e cila në fund të vitit është konvertuar me kursin në lek të datës 31.12.2020 dhe është e barabartë me **309,250** (treqind e njente mijë dyqind e pesëdhjetë lek). Krahasuar me kapitalin e vlerësuar në fund vitin 31.12.2019 i cili është i barabartë me një shumë prej **304,425** (treqind e katërmijë e katerqind e njetzet e pesë lek) rezulton një diferencë prej **4,825** (katërmijë e teteqind njetzet e pesë lek) shumë e cila pasqyrohet në zërin e efekteve të ndryshimeve të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit në zbatim të SNK nr. 21.
2. Zëri Fitimet e mbajtura ndër vite në bilancin e Kosovës është **171,010 euro** që përbëhet nga **137,749** euro fitimi dhe humbja e viteve të kalura si dhe **33,261** eur fitimi i periudhës. Fitimi i mbartur nga vitet e kaluara në vitin 2019 është vlerësuar 20,823,912 Lek dhe në vitin 2020 është vlerësuar me një vlerë 21,153,962 Lek. Diferenca = 330,050 lek është vendosur në pasqyrën e konsoliduar të ndryshimit të kapitalit.
3. Gjithashtu në zërin e rezervave të konvertimit të monedhave të huaja është pasqyruar dhe shuma **7,673,695** (shtatë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë, gjashtëqind e nentëdhjetë e pesë lek), e cila vjen si rezultat i konsolidimit të pasqyrave financiare të shoqërisë për detyrimet e shoqërisë mëmë ndaj filialit, azhornim sipas SNK nr. 21 pika 15, (diferencat nga kursi i këmbimit, që rrjedhin nga përkthimi i huave të tilla, do të njihen në zërin e kapitalit dhe jo si fitim ose humbje nga kursi i këmbimit në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve).
Shoqëria në pasqyrat e saj financiare në zërin hua të tjera ka të pasqyruar shumën në euro 4,077,175 (katërmilion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë euro) të konvertuara me kursin historik me një vlerë prej 512,020,242 (peseqind e dymbëdhjetë milion e njetzetmijë e dyqind e dyzet e dy lek) në fund të vitit.

Gjithashtu filiali ka të pasqyruar në llog e Huadhënive të përkohshme të njëjtën shumë në euro e konvertuar me kursin e fundvitit 1 Euro =123.7 ALL rezulton me vlerë 504,346,548 lek (peseqind e kater milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e dyzet e tete lek) dhe diferenca midis 512,020,242 - 504,346,548 = **7,673,695** lek pasqyron zbritjet në vlerën neto të kapitalit nga konsolidimi.

PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen të lidhura nëse njera palë ka aftësinë për të kontrolluar apo ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo operationale, ose nëse palët janë nën kontroll të përbashkët me kompaninë. Shoqëria ka ndërmarrë një sërë transaksionesh me palët e lidhura gjatë aktivitetit normal të biznesit. Këto transaksione janë kryer në kushte tregu me terma normale. Gjendja në fund të periudhës i këtyre transaksioneve është si më poshtë:

Nr	Kompania	Monedha	Detyrimi ne fillim te periudhes	Faturime	Arketime	Detyrimi ne fund te periudhes
1	Gjoka 87 shpk	Lek	5,777,724,417	6,742,738,225	3,413,225,000	9,107,237,642



2	Gjoka Konstruksion Energji shpk	Lek	59,531,350	-	-	59,531,350
3	Diteko shpk	Lek	1,638,393,238		273,500,000	1,364,893,238
	Totali		7,475,649,005	6,742,738,225	3,686,725,000	10,531,662,230

Kerkesa te tjera nga kompani të lidhura:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>
1. Gjoka Konstruksion - Përfaqësia Kosovë	- 512,020,242 lek
2. Kompania "Gjoka Konstruksion Energji Shpk"	303,978,259 lek
3. Kompania "Diteko shpk"	197,728,110 lek

Gjithsej - 10,313,873 lek

Gjatë periudhës së raportimit nuk ka patur përfitime afatgjata dhe as shpërblime për përfundim të mardhënies së punës të paguara për drejtuesit kryesorë dhe nuk ka transferim të shpenzimeve për stafin drejtues në kompanitë e grupit.

NGJARJET PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Nuk ka ngjarje tjetër pas datës së raportimit që kërkon rregullime apo informacione shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare të shoqërisë.

"GJOKA KONSTRUKSION" SH.A

Administratori

Rrok GJOKA



(Handwritten signature)



GJOKA Konstruksion Sh.a.

Rr. "Dora D'Istria, Hyrja 1 dhe 2. TIRANA, ALBANIA

tel./fax.:+355 4 2274 809; mobile: +355 069 20 64 602

e-mail: info@gjoka.al

Nr prot: Extra

Tirane, me 11.1.2021

"GJOKA KONSTRUKSION" SHA

NIPT: J91815014U

INVENTARI DATE 31.12.2020

NR.	LLOJI I MATERIALIT	NJESI	SASI	CMIM	VLERE
1	Nafte	liter	11,490	109.77	1,261,311
2	Hekur	Kv	26	5,298.13	137,751
					-
TOTALI					1,399,063

Administratori

Rrok Gjoka



RAPORTET FINACIARE 2020



Gjoka Konstruksion Përfaqësia Kosovë Kompani e huaj

Keto pasqyra financiare jane përgjitur në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme(SNRF për NVM-të)dh UA 07/2019 sipas ligjit 06/L-032 Per Kontabilitet,Raportim financiar dhe Auditim

2020



Përmbledhja

(1) Pasqyra e pozitës financiare.....	2
(2) Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse.....	3
(3) Pasqyra e ndryshimeve në Ekuitet.....	4
(4) Pasqyra e rrjedhjes së parasë së gatshme.....	5
(5) Deklerata e drejtorit Ekzekutiv.....	6
(6) Deklerata e përgjegjësimit financiar.....	6
(7) Shënimet shpjeguese, përfshirë përmbledhjen e politikave domethënëse kontabël, si dhe informacionet tjera shpjeguese.....	7-18

Të gjitha të drejtat për publikim të raporteve financiare i mban administratori i nuk lejohet publikime të këtyre raporteve pa pelqim paraprak me shkrim



Gjoka Konstruksion Përfaqësia Kosovë

Numri I Biznesit: 810793142

Pasqyra e Pozitës financiare SNRF per NVM

më 31 dhjetor 2020

BILANCI I GJENDJES

Baza Akruale e Raportimit me kosto historike

GJOKA
KONSTRUKSION

në 0.00 €

në 0.00 €

PASURITË	Shënimi	2020	2,019
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	49,199	801,693
Investimet financiare afatshkurtra		-	-
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	4	4,613,655	3,375,109
Inventari, Stoqet	5	-	-
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		4,662,854	4,176,802
Pasuritë afatgjata			
Investimet financiare afatgjata	6	-	-
Prona, paisjet dhe impijantet	7	-	-
Prona investuese		-	-
Pasuritë e paprekshme	8	-	-
Pasurite e shtyra tatimore	9	-	-
Pasurite tjera afatgjata		-	-
Gjithsej pasuritë afatgjata		-	-
Zhvlersimi I mjeteve Themelore		-	-
GJITHSEJ MJETET		4,662,854	4,176,802
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare		-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	10	4,385,021	4,003,291
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		4,385,021	4,003,291
Detyrimet afatgjata			
Provizionet afatgjata	12	-	-
Detyrimet ndaj lizin-ut pjese afatgjate	13	-	-
Detyrimet e shtyra tatimore		-	-
Gjithsej detyrimet afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet		4,385,021	4,003,291
EKUITETI			
Kapitali aksionar	19	2,500	2,500
Fitimet e mbajtura		275,333	171,010
Rezervat e tjera		-	-
